



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 12.07.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË – DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, NË KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN I BALLKANIT PERËNDIMOR

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.07.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat Shqiptare- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë –Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor “në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit

Në mbledhjen e Komisionit rehatoi projektligjin Z. Erjon Luçi Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës” nëpërmjet një granti në shumën 35 435 000 euro, i cili akordohet nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor.

Ky projekt synon realizimin e dy qëllimeve kryesore:

- Ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës; dhe
- Modernizimin e linjës ekzistuese Tiranë – Durrës, nëpërmjet përmirësimit të karakteristikave gjeometrike dhe operacionale të vijës hekurudhore në përputhje me standardet e BE-së, të përcaktuara nga direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, për të rritur efikasitetin dhe sigurinë e transportit hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet Tiranës, Durrësit e Aeroportit të Rinasit dhe, në të njëjtën kohë, për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik të zonës ekonomike të rajonit të Durrësit, Tiranës dhe të gjithë vendit.

Kjo marrëveshje synon zbatimin e projektit të detajuar për rehabilitimin e hekurudhës Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore me Aeroportin e Rinasit, hartuar në bazë të marrëveshjes së grantit, datë 13 mars 2015, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe BERZH-it, si administrator i fondeve grant të siguruara nga qeveri të ndryshme nën Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor.

Projekti përmbush objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2015 - 2020 për modernizimin e hekurudhave. Projekti, që pritet të realizohet nëpërmjet financimit që do të sigurohet me anë të marrëveshjes në fjalë, është ndër prioritetet parësore për rrjetin hekurudhor, sipas dokumentit strategjik 2016 – 2020 të planit të veprimeve prioritare të sektorit hekurudhor.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të zhvillojë transportin hekurudhor ndërmjet Durrësit dhe Tiranës, duke përmirësuar infrastrukturën dhe operacionet hekurudhore, garantuar sigurinë e lëvizjes dhe ndërveprimin, si dhe duke ndërtuar një lidhje të re hekurudhore për në Aeroportin e Rinasit.

Objektivat kryesorë në drejtim të rezultateve lidhen me rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore nga stacioni qendror hekurudhor Durrës deri në vendndodhjen e ardhshme të Terminalit të

Transportit Publik të Tiranës për një gjatësi 34.2 km dhe, gjithashtu, për të ndërtuar një linjë të re hekurudhore që lidh linjën kryesore me Aeroportin e Rinasit (gjatësi 4.7 km), duke përfshirë dhe degëzimet shtesë, respektivisht, për të lidhur linjën e re me Terminalin e Transportit Publik Tiranë si dhe me qytetin e Durrësit. Projekti parashikon, gjithashtu, ndërtimin e një terminali hekurudhor në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës si dhe instalimin e një sistemi të ri sinjalizues e telekomunikacioni, të integruar në sistemin e linjës hekurudhore Durrës - Tiranë - Rinas.

Për realizimin e këtij projekti, më 29 dhjetor 2016 është nënshkruar marrëveshja e huas, në shumën 36 870 000 euro, për financimin e pjesshëm të projektit në fjalë, e cila është ratifikuar me ligjin nr.29/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.

Granti i Fondit të Ballkanit Perëndimor do të plotësojë financimin e nevojshëm për projektin, duke synuar bashkëfinancimin deri në 50 për qind të kostove kapitale të tij, financimin e mbikëqyrjes së punimeve dhe mbështetjen për zbatimin e projektit.

Projekti parashikohet të përfundojë deri më 31.12.2020.

Granti, në shumën prej 35 435 000 eurosh, që do të akordohet nga BERZH, do të përdoret për:

- financimin e punimeve për rehabilitim të linjës ekzistuese dhe ndërtimin e linjës së re, në kuadër të projektit,
- shërbimeve të mbikëqyrjes së punimeve
- dhe mbështetjes për zbatimin e projektit

Financimi me Grant do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të Zërave përkatës të projektit që duhet të prokurohen në përputhje me rregulloren e BERZH për prokurimet.

Të ardhurat e Financimit të Grantit nuk përdoret, direkt apo indirekt, për të paguar ndonjë taksë, të drejtpërdrejtë apo jo, në territorin e Përfuturës.

Zbatimi i projektit do të bëhet nga “Hekurudha Shqiptare”, sh.a., në cilësinë e njësisë së projektit, dhe do të mbështetet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Marrëveshja, e cila është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.110, datë 23.2.2018, si dhe është nënshkruar ndërmjet palëve më 9.5.2018, do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja përmban Preambulën dhe 9 nene të cilat janë të ndara në seksione

5.0 Diskutimet në Komision

Deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e projektligjit dhe kërkuar sqarime se sa është shtrirë linja, kur do të fillojë nga funksionimi, a ka një afat kohor për përfundimin e punimeve. Deputetet morën një informacion me të hollësishëm për projektligjin dhe shprehën kënaqësinë që projekti, linja hekurudhore Tirane Durrës do të fillojë së shpejti nga funksionimi.

6.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, i cili është organi kompetent sipas përcaktimeve që i bën neni 81 i Kushtetutës së Shqipërisë. Projektligji shoqërohet dhe me relacionin përkatës sipas nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjes “*Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat Shqiptare- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë –Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor* “ është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’ në të cilën thuhet “

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.
2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:
 - a) projektligji për ratifikim;
 - b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;
 - c) vendimi i miratimit në parim;
 - ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;
 - d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;
 - dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.
3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

